



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:120008

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05873761

KPPP.nr.719/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit “Tafaj&Co” SH.P.K., me numër unik identifikues 810200600, me seli në Suharekë, Magjistralja Suharekë – Prizren të cilin sipas autorizimit e përfaqëson shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” SH.P.K. me seli në Prishtinë, Soliteri Avalla P+12, kundër debitorit “AgroKosova Holding” SH.P.K., me numër unik identifikues 810529894 me seli në fshatin Shirokë, Komuna e Suharekës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.36/22 të datës 03.03.2022 të Përbaruesit Privat Fadil I. Hoxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “AgroKosova Holding” SH.P.K., i ushtruar ndaj Urdhrit P.nr.36/22 të datës 03.03.2022 të Përbaruesit Privat Fadil I. Hoxha.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr.36/22 i datës 03.03.2022 i lejuar nga Përbaruesi Privat Fadil I. Hoxha, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Tafaj&Co” SH.P.K., ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.36/22 të datës 03.03.2022 me të cilin e ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës me nr. 21-SHV01-001-2632 të datës 26.08.2021 në shumë prej 71.50€, Faturës me nr. 21-SHV01-001-2648 të datës 28.08.2021 në shumë prej 134.00€, Faturës 21-SHV01-001-3463 të datës 01.12.2021 në shumë prej 1,080.00€ dhe Faturës 21-SHV01-001-147 të datës 26.01.2022 në shumë prej 7,439.00€, me të cilin ka detyruar debitorin

që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumën prej 8,724.50€ me kamatë ligjore prej 8% deri në pagesën e plotë si dhe shpenzimet e procedurës së përbarimit përmes bllokimit të të gjitha llogarive bankare dhe regjistrohet, konfiskohet dhe shitet pasuria e debitorit si në sende të luajtshme po ashtu edhe paluajtshmëri të tjera në tërë masën pasurore të debitorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) në tërësi ka kundërshtuar urdhrin përbarimor me arsyetimin se i mungon legjitimiteti procedural për faktin se AKP, nuk administron me “AgroKosova Holding” SH.P.K., por me “Ndërmarrja e re AgroKosova Holding” si dhe shton se AKP, nuk ka krijuar asnjë raport juridik me kreditorin andaj edhe nuk mund të jetë palë në këtë procedurë përbarimore. Më tej ka shtuar se kjo procedurë përbarimore bazohet në fatura të cilat janë kopje dhe si të tilla në bazë të tyre nuk është dashur të veprohet nga ana e përbaruesit, po ashtu ka kontestuar faturat duke shtuar se nga informatat e siguruar nga punëtorët e debitorit malli i cili është objekt i faturës së datës 22.01.2022 nuk ekziston, si dhe ka kontestuar nënshkrimin në disa fatura. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të anulohet Urdhri Përbarimor P.nr.36/22 i datës 03.03.2022.

Kreditori brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën ka kundërshtuar pretendimin e debitorit për mungesë të legjitimitetit pasiv, pasi që e sipas kreditorit debitori në kohën e lëshimit të urdhrin përbarimor në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, debitori evidentohet nën menaxhimin e AKP-së. Po ashtu as i përket kundërshtimeve në lidhje me faturat kopje dhe kontestimin e pranimit të mallit ka deklaruar se faturat i janë bashkangjitur urdhrin në formë origjinale dhe se të gjitha janë pranuar nga debitori.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata vlerëson se Urdhri Përmbarimor P.nr.36/22 i datës 03.03.2022 bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht Faturën nr. 21-SHV01-001-2632 të datës 26.08.2021 Faturën me nr. 21-SHV01-001-2648 të datës 28.08.2021, Faturën 21-SHV01-001-3463 të datës 01.12.2021 dhe Faturës 21-SHV01-001-147 të datës 26.01, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në to janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Për më tepër, gjykata gjen se faturat mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Ndërsa, lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim në lidhje me mungesën e legjitimitetit pasiv të palës në procedurë, gjykata gjeti se në kohën e ushtrimit të Urdhrit Përmbarimor P.nr.36/22 të datës 03.03.2022, debitori ka qenë nën menaxhimin e AKP-së, andaj e gjykata vlerëson se e njëjta ka legjitimitet të palës në procedurë.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.719/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.